



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Integritim Evropian
Mbledhja nr.
Prishtinë, më 10. 09. 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Integritim Evropian

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova dhe Branislav Grbić.

Pjesëmarrës tjerë: Michele Dinelli-UNDP, Maria Berisha - OSCE, Jules Caron - OSCE, Nexhat Shatri - ZP, Fitore Zeneli - KDI, Agron Demi - GAP, Avni Zuka - NDI, Jan Meyer - Universiteti i Bremenit, Jeton Bytyçi - AEI, Federike Wünschmann.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Minire Hasani dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 3. Shqyrtimi i Projektplanit dhe i programit të punës së Komisionit deri në dhjetor 2008,**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për kualifikimet kombëtare me amendamentet, nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së,**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesja, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektplanit dhe i programit të punës së Komisionit deri në dhjetor 2008

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se UNDP-ja e ka angazhuar një ekspert për ta ndihmuar punën e Komisionit dhe se ka filluar të funksionojë Divizioni i Standardizimit. Shtoi se është hartuar Projektplanin i punës së Komisionit. Tha se është një projekt i përgjithësuar dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit që deri në ditën e hënë t'i dorëzojnë propozimet dhe vërejtjet e tyre, në mënyrë që të konkretizohet plani. Po ashtu kërkoi të caktohet nga një raportues për çdo projektligj. I ftoi ekspertin për mbështetje të Komisionit dhe udhëheqësin e Divizionit t'i njoftojnë anëtarët e Komisionit për aktivitetet e tyre.

Michele Dinelli - Ekspert nga UNDP-ja për mbështetje të Komisionit, njoftoi se e ka punuar Projektplanin dhe tha se e pret kontributin tuaj. Kam njohuri për Bashkimin Evropian dhe për të drejtën evropiane, por ju jeni ekspertë që i dini nevojat e Kuvendit të Kosovës.

Arsim Avdiaj - Udhëheqës i Divizionit për Standardizim të ligjeve në Kuvendin e Kosovës, i njoftoi anëtarët e Komisionit për punën që kryen ky divizion. Shtoi se detyrë kryesore e ka harmonizimin e amendamenteve që i paraqesin komisionet kryesore dhe funksionale. Lidhur me amendamentet tha se deri më tani pjesa më e madhe e tyre ka karakter teknik dhe jo përmbajtjesor.

Naser Rugova - Në parim e përkrahu planin e punës por tha se duhet të specifikohet që të operacionalizohet. Lidhur me caktimin e raportuesve tha se mund ta bëjmë me radhë ose varësisht nga profesionet, por gjithnjë në koordinim të ngushtë me ekspertët. Propozoi të organizohet një dëgjim publik për t'i paraqitur të gjitha të arriturat e Komisionit që nga themelimi i tij.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Anëtarët e Komisionit deri të hënën duhet t'i dorëzojnë propozimet për konkretizimin e Projektplanit të punës së Komisionit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për kualifikimet kombëtare me amendamentet, nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja - Njoftoi se nga Komisioni përgjegjës dhe referues i P/ligjit për kualifikimet kombëtare janë dërguar amendamente të natyrës teknike që nuk ndikojnë në përmbajtjen e ligjit.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Komisioni konstatoj se P/ligji për kualifikimet kombëtare me amendamente nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.

5. Të ndryshme

a) Rreth vizitës në Bruksel.

Kryesuesja – I njoftoi anëtarët e Komisionit se vizita e organizuar nga OSBE-ja do të bëhet më 7 dhe 8 tetor. Propozoi të analizohet raporti i progresit i përgatitur nga Komisioni Evropian dhe në takimin që do ta kenë me ta t'i paraqesin të arriturat e institucioneve të Kosovës.

Naser Rugova – E kërkoi agjendën e hollësishme për t'i përgatitur dhe për t'i ndarë detyrat, në mënyrë që Kuvendi të përfaqësohet sa më mirë nga Komisioni për Integritet Evropian. Shtoi se krahasimet ndërmjet raportit të Komisionit Evropian dhe progresit të arritur nga institucionet e Kosovës, duhet të analizohen hollësisht që të mos dalin joserioze.

Kryesuesja - U pajtua me propozimin e deputetit Rugova dhe kërkoi nga organizatorët që agjenda e hollësishme t'u dorëzohet anëtarëve sa më parë që të jetë e mundshme.

Nait Hasani - Tha se kemi diskutuar edhe më parë lidhur me caktimin e anëtarëve që do të shkojnë për Bruksel. Shtoi se para vetes kishte një dokument me emrat e anëtarëve që do të marrin pjesë në këtë takim, por nuk e di nga kush janë caktuar. Tha se në mbledhjen e mëparshme në diskutimin rreth asaj se kush duhet të shkojë e kush jo, ishte korrekt dhe se e kishte thënë atë që është dashur ta thoshte. Propozoi të ketë një rregull se kush duhet të shkojë në udhëtime. Si rregull, tha se opozita asnjëherë s'mund t'i mbrojë politikat e Qeverisë. Shtrohet pyetja se kush do t'i mbrojë interesat në këtë rast. Ai propozoi: të shkojnë katër anëtarë nga pozita. Të shkojnë me radhë kryetarja e Komisionit dhe anëtarët e opozitës.

Edita Tahiri - Tha se në parim në çdo delegacion pozita duhet të jetë më shumë e përfaqësuar se opozita. Propozoi që në mbledhjen e ardhshme të caktohet si pikë e rendit të ditës diskutimi për hartimin e parimeve për udhëtim.

Kryesuesja - Tha se do të shkojmë për ta mbrojtur punën e institucioneve të Kosovës, pavarësisht a jemi pozitë apo opozitë. Lidhur me numrin e anëtarëve të opozitës në këtë takim tha se janë në numër më të vogël se anëtarët e pozitës. Shtoi se ka pritur që grupi juaj parlamentar t'i caktojë emrat, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe mua më është dashur t'i jap emrat tek organizatorët, në mënyrë që të mund ta realizonim vizitën.

Džezair Murati njoftoi anëtarët e komisionit se në kryesi mbretëron bindja se gjatë vizitave nuk duhet të udhëtojë komplet komisioni por nga një përfaqësues prej secilit grup parlamentar. Ai shtoi ndihem keq për këtë sepse disa grupe parlamentare kanë më shumë anëtar dhe është vështirë të përcaktohen. Ai propozoi të gjendet një modus për të përcaktuar mënyrën e përzgjedhjes së delegacioneve.

Njomza Emini - Tha se deri më tash kemi funksionuar shumë mirë si Komision. Lidhur me atë se si duhet të përfaqësohen anëtarët e opozitës shtoi se po qe se vjen ftesa që të përfaqësohen të gjitha grupet parlamentare, ne s'mund të heqim dorë dhe të themi të shkojë vetëm pozita. Është në interes të të gjithë neve që t'i mbrojmë institucionet tona atje, pavarësisht se a jemi pozitë apo opozitë. U pajtua me propozimin që të hartohen parimet për mënyrën e realizimit të vizitave.

Kryesuesja - Shtoi se OSBE-ja kishte kërkuar që në këtë vizitë të jetë nga një përfaqësues i secilit grup parlamentar.

Fatmir Rexhepi - Tha se në rastet kur kemi kërkesë të determinuar, është e pamundshme të bëhen lëvizje, por në rastet kur Komisioni ka mundësi t'i caktojë pjesëmarrësit, duhet t'i kemi dy

kritere: të respektohet përfaqësimi i votës dhe të caktohet nga ana e pozitës një radhë sipas së cilës çdo anëtar të ketë mundësi të shkojë dhe të mos jetë çdo herë i njëjti.

Hydajet Hyseni - Lidhur me planin e punës tha se është i përgjithësuar dhe i pakonkretizuar me aktivitet. Lidhur me komunikimin e jashtëm tha se më e rëndësishme është si bëhet përfaqësimi e jo nga kush bëhet. Propozoi që të punojnë së bashku të gjithë anëtarët dhe ta orientojnë politikën e Komisionit, pastaj mund të shkojë cilido anëtar i Komisionit dhe t'i përfaqësojë ata sa më mirë. Tha se është defekt në rastet kur duhet ta përfaqësojmë sa më mirë secilin grup parlamentar, sepse kemi grupe që kanë më shumë se dy deputetë. Propozoi për grupet që kanë më shumë se dy deputetë në Komision, t'i kenë se paku nga dy deputetë në delegacione. Ai shtoi se me rregullore kryetarja i ka disa kompetenca për të vendosur vetë për përbërjen e delegacionit.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Ne mbledhjen e ardhshme të Komisionit pikë e rendit të ditës të jetë caktimi i parimeve të udhëtimit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10 min.

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit
Zylfije Hundozi